



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2458/11 Prot.

Tiranë, më 04.11.2025

VENDIM

Nr. 336, datë 29.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
PËR PROKURORIN PALI DEÇOLLI”**

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenin 95, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 159, 161, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “a”, 190 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në Vendimin nr. 95, datë 09.05.2022, “Për miratimin e Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, e ndryshuar, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe pasi u njoh me projektraportin e përgatitur nga Relatori, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit Pali Deçolli, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, duke e vlerësuar si më poshtë:
 - a. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm” – 94 (nëntëdhjetë e katër) pikë;
 - b. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm” – 99 (nëntëdhjetë e nëntë) pikë;
 - c. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm” – 100 (njëqind) pikë;
 - d. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm” – 95 (nëntëdhjetë e pesë) pikë.
 - Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm” – 388 (treqind e tetëdhjetë e tetë) pikë.
2. Raporti i vlerësimit sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, vetëm për shkelje të rënda procedurale.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në përputhje me nenin 95, pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

U shpall në Tiranë, sot më 29.10.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erion Fejzulla